

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE VLORE
NOTERE ANILA BARDHI KUCOVE
NR. 842 REP.NR. 243 KOL

*Realizim e pultes
u fuqzues
H. Bardhi*



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Kucove, sot ne daten 21.5. 2003 (dymije e tre), dite e Mercurit, para meje noteres Anila Bardhi, ne zyren e noterise ne lagjen "Ll. Prifti", u paraqiten personalisht pale per lidhjen e kesaj kontrate te cilet kane keto identitete:

PALE SHITESE: Maksim Nasto, i biri i Kostas, i datelindjes 28.10.1956, lindur dhe banues ne Kucove, lagja "1 Maji", i njohur prej meje personalisht.

PALE BLERESE: Nikollaq Nasto, i biri i Kostas, i datelindjes 09.10.1953, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Kucove, lagja "1 Maji", per identitetin e te ciles u sigurova me leternjoftimin personal QHNR.449598.

Shtetasit jane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me dispozitat ligjore nenin 47 te Ligjit nr.7638 date 19.02.1992, nenin 705 te Kodit Civil, palet me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe sinqerte lidhin kete kontrate duke bere keto deklarime dhe sipas ketyre kushteve:

Shitesi eshte ortak i shoqerise « Kucova », shpk me seli ne Kucove, regjistruar si person juridik me vendim numer 18418/2 date 03.04.2002 te gjykates se rrethit Tirane. Ai zoteron ne kete shoqeri 10% te kapitalit te pergjithshem me nje vlere prej 10.000(dhjetë mijë)lekeve. 5% te kapitalit ai deklaroi se ia shet Z.Nikollaq Nasto.

Bleresi deklaroi se eshte dakort qe te bleje 5% te kapitalit qe ka Maksim Nasto ne kete shoqeri me nje cmim prej 5000(pese mijë)leke.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate Maksim Nasto i ngelet 5% e kapitalit ne shoqerine «Kucova» ndersa bleresi Nikollaq Nasto perfiton ne kete menyre 5% te kapitalit te shoqerise « Kucova » shpk duke fituar keshtu te gjitha te drejtat dhe detyrimet si ortak i shoqerise « Kucova » shpk.

Kontrata u redaktua ne tre origjinale me permbajtje te njejte dhe pasi lexohet nenshkruahet pa verejtje.

Une noteria legalizoj redaktimin e saj dhe vertetoj autenticitetin e nenshkrimeve.

PALA SHITESE

PALA BLERESE

NOTERE
ANILA BARDHI

Maksim Nasto
[Signature]

Nikollaq Nasto
[Signature]

[Signature]